

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

”Blerje materiale per ngrohje gaz viti 2025”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
44115220-7**

VLERA E FONDIT LIMIT:

2,316,408 (dy milion e treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind e tetë) lekë pa tvsh

Vlera e fondit limit është përllogaritur bazuar në Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, Kreu VI “rregulla të përgjithshme dhe përgatitja e procesit të prokurimit”, neni 34 “Përllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”, Vendimit nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i nryshuar, neni 12 “Metoda të zbatueshme në përllogaritjen e vlerës së kontratës”. Komisioni i përllogaritjes se fondit limit i ngritur me Urdher Titullari bazuar ne Vendimin nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar, Neni 12 “Metoda të zbatueshme në përllogaritjen e vlerës së kontratës, ka llogaritur fondin limit per proceduren.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Maliq ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Per proceduren e prokurimit “Blerje materiale për ngrohje gaz” Viti 2025,
Skicimet, parametrat teknik etj:

2. LOTI 2 “BLERJE GAZ I LENG SHEM GNL PER NGROHJE”

Gazi i lëngshëm do të përdoret për ngrohje.

Gazi i lëngshëm duhet të ketë karakteristikat e GNL, në përputhje me Standardin Shqiptar SSH EN 589:2018 dhe te jete ne peputhje me percaktimet e bera ne VKM-së nr. 429, datë 26.06.2019, “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”

Gazi duhet te permbushe kriteret teknike te sigurise.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Gazi i lëngshëm do te levrohet me autobotin e shoqerise ne kaldajen e “Shkolles Myredin Bashalli”, sipas kerkeses te autoritetit kontraktor.

Gazi i lëngshëm duhet të ketë karakteristikat e GNL, në përputhje me Standardin Shqiptar SSH EN 589:2018 dhe te jete ne peputhje me percaktimet e bera ne VKM-së nr. 429, datë 26.06.2019, “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”

1. Gazi duhet te jete perzierje e butanit me propanin ne masen 60% butan dhe 40% propan.

2. Gazi duhet te permbushe kriteret teknike te sigurise

3. Gazi te jete cilesor dhe brenda kushteve teknike dhe me certificate cilesie

4. Gazi i duhet te permbushe kerkesat sipas standarteve ne fuqi

5. Gazi duhet te jete pa ere

Gazi duhet te jete i cilesise se pare

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):
Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2022,2023,2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për ”Procedurës Tatimore ”neni 64 Deklarata Tatimore.

2.2.2. Kopje të vërtetuar të bilancit per vitet 2022,2023,2024 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetet për vitin 2025 sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “PërSistemin e TaksaveVendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurattatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga shpallja e njoftimit të kontratës, ku vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% i fondit limit të kësaj kontrate

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori/et Ekonomik duhet të paraqesë/in licencat përkatëse **për tregtimin me pakicë të karburanteve**, gazit të lëngshëm të naftës, vajrave lubrifikant edhe lëndëve djegëse **për përdorim nga konsumatorët fundorë**. (Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes të furnizimeve, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është në përputhje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 5/a, pika 7/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore dhe

ushtrinë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës ç'ka bën operatorin ekonomik fitues me të përgjigjshëm për produktet që oferton.

Për këtë arsye, i referohemi zbatimit të ligjit Nr. 8450 dt. 24.2.1999 “Për përpunimin transportimin, tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, ligjit Nr. 32/2016 dt. 24.03.2016 “Per garantimin e sigurise se punes se paisjeve dhe instalimeve nen presion” VKM nr.212, date 16.03.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të gazit të lëngëzuar te naftës”,si dhe V.K.M. nr.970 dt. 02/12/2015 “Per percaktimin e procedurave per dhenien e licencave per tregtimin e naftes bruto dhe nenprodukteve te saj”.

2.3.3 Operatori/et Ekonomik duhet të detyrimisht duhet të paraqes/in dëshmi Raport analizë për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuar nga Inspektorati Shtetror Teknik dhe industrial “ISHTI” të shoqëruar me vërtetim teknik të ISHTI-së **ose** nga një laborator i certifikuar në Republikën e Shqipërisë . Fletë analiza duhet të jetë lshuar brenda **6 muajve** nga data e hapjes se ofertave, (për fletë analizën e lëshuar nga laboratorë të huaj duhet të jetë e përkthyer dhe noterizuar), në përputhje me standartet në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40, pika 6/c dhe pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi ka të bëjë me informacion e nevojshem se ku prodhohet malli dhe mundësinë reale për të bërë furnizimin , nëpërmjet raport analizës që i jepet operatorit ekonomik ofertues.

Referuar **nenit 77 pika 4** të ligjit nr.**162** datë 23.12.2020 “**Për prokurimin publik**”, parashikohet shprehimisht: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e raport analizës lidhet ngushtë me objektin e kontratës dhe u vendos me qëllim që të vërtetohet se gazi që operatori tregëton është konform standarteve në fuqi. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë se janë të certifikuar nga autoritetet kompetente.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te paraqese nje Deklarate ne baze te se ciles merr persiper furnizimin me gaz me autobotin e tij dhe shpenzimet e tij deri ne vendin ku ndodhen depozitat e autoritetit kontraktor duke zbatuar të gjitha dispozitat ligjore për transportin e lëndëve djegëse, sipas standarteve ne fuqi.

Argumentimi: Kriteret i mesiperm lidhet ngushtë me objektin e kontratës dhe u vendos me qëllim që të vërtetohet që operatori ekonomik ka aftësinë zbatuese konform standarteve në fuqi. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në

të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë se janë të aftë për të realizuar me sukses furnizimin me gaz.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të deklarojë në formularin e vetdeklarimit se ka në pronësi ose me qera një mjet transporti Autobot për transportin e gazit.

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike Operatori/et ekonomik duhet të paraqesë:

- Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet :
 - a) për mjetet në pronësi të vertetuara me :
 - leje qarkullimi
 - certifikatë e kontrollit teknik të mjetit(të vlefshme)
 - policen e sigurimit të mjeteve (të vlefshme)
 - Çertifikatën për transport mallrash të rrezikshme brenda vendit (te vlefshme).
 - foto të mjetit
 - b) për mjetet e siguruara me qera
 - kontrate qiraje (të vlefshme)
 - leje qarkullimi
 - certifikatë e kontrollit teknik të mjetit(të vlefshme)
 - policen e sigurimit të mjeteve (të vlefshme)
 - Çertifikatën për transport mallrash të rrezikshme brenda vendit (te vlefshme).
 - foto të mjetit

Ne rastin e mjeteve të marra me qera nga operatorët ekonomikë bazuar në njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit(leje qarkullimi,certifikate e transportit të mallrave) ,mjetet nuk duhet të rezultojnë për përdorim vetjak por për përdorim nga të tretet.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Për sa më sipër është e nevojshme vendosja e kriterit për disponimin e një autoboti i cili duhet të jetë i pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për qarkullim në mënyrë që të realizohet me sukses furnizimi me gaz.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.